



BASHKIA ROSKOVEC

**OBJEKTI: NDËRTIMI I ÇATISË SË SHKOLLËS 9-VJEÇARE “ALUSH GREPCKA”,
ROSKOVEC**

RELACION TEKNIK

Miratohet:

Kryetari i Bashkisë

Majlinda Bufi



Evidentim i gjendjes ekzistuese:

Sot qyteti i Roskovecit ndodhet në një fazë zhvillimi dhe popullsia në përbërje të tij vjen gjithnjë e më tepër në rritje. Me shtimin e popullsisë dhe sidomos të grupmoshave të reja, kërkesat dhe nevojat e tyre vijnë duke u rritur. Aktualisht në këtë qytet ndodhen disa ambiente si bare, restorante apo sheshe urbane të gjelbëruar, të cilët ofrojnë mundësi për banorët, që të socializohen dhe argëtohen. Megjithëkëtë grupmoshat e reja kanë nevojë për ambiente konkrete ku mund të shtojnë horizonte, të shpalosin idetë dhe mendimet e tyre, të përkrahen dhe të argetohen.

Sot një nga mënyrat e pushtetit vendor, në të gjithë botën për të siguruar zona të tilla është përdorimi i territoreve të jashtme të shkollave publike. Këto të fundit kthehen në qendra të mirëfillta komunitare, të cilat shfrytëzohen nga nxënësit gjatë orarit mësimor, dhe nga komunitati gjatë pjesës tjetër të ditës. Një prej këtyre shkollave është menduar të jete shkolla 9-vjeçare publike “Alush Grepcka”.

Përshkrim:

Shkolla 9-vjeçare ”Alush Grepcka” ndodhet pranë rrugës kryesore që lidh Fierin me Beratin. Kjo shkollë është rikonstruktuar në vitin 2013. Shkolla ka një sipërfaqe 860 m² dhe sipërfaqe të jashtme 9460 m².

Kapaciteti:

Shkolla është 2 kateshe, ka rreth 562 nxënës dhe mësimi zhvillohet me 1 turn .

Vendndodhja: Rruga nacionale ”Fier- Berat”, Bashkia Roskovec.



Vlerësimi fizik i objektit:

- Hidroizolimi i tarracës është i dëmtuar
- Lagështira ndihet ndjeshëm në klasat e shkollës
- Sistemimi i ambienteve të jashtme është bërë kohët e fundit dhe ndërtimi i çatisë do të ishte ndër të tjerash kompletim i punimeve emergjente të shkollës.

Shkolla 9-vjeçare “Alush Grepcka” propozohet për trajtimin e këtyre problematikave të mësipërme, të cilat kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme, për mbarëvajtjen e proceseve mësimore.

Sipërfaqja e sheshit të ndërtimit është 9500 m², ndërsa gjurma e objektit të shkolles shkon rreth 830 m², ndërsa kopshti i ri i ndërtuar 170 m², objekti i abandonuar 120 m².


Pozicionimi i objektit në këtë territor i krijon atij mundësinë që të ketë hyrje nga të dyja anët e rrugës si në veri ashtu edhe në juglindje, duke krijuar më shumë akses për këmbësorët. Rrugët rrethuese janë në gjendje mjaft të mirë, të shtruara me asfaltobeton dhe me trotuare në të dyja krahët, ku nuk mungojnë vijat e bardha për kalimin e këmbësorëve. Ndërkaq terreni është kodrinor dhe prania e shkallëve krijon lodhje. Nevojitet një risistemim dhe gjërmim i dherave.

Problematikë përbën edhe mungesa e një hapësire grumbulluese dhe rekreative në këtë zonë. Një e tillë do të shërbejë jo vetëm në funksion të objektit, por edhe për komunitetin përreth.

Qëllimi i rehabilitimit:


Në këtë shkollë gjëndja ekzistuese shfaq problem urgjent infiltrimin e ujrave të reshjeve nga soleta në ambientet e brendshme duke cënuar standartet minimale për zhvillimin normal të orëve mesimore. Hidroizolimi bituminoz tejet i amortizuar nuk arrin të pengojë depertimin e reshjeve në plasaritjet e soletës që janë theksuar së tepërmigjatw viteve tw fundit. Catia është zgjidhja teknike e detyruar për të garantuar hidroizolimimin e ambienteve të brendshme në mënyrë përfundimtare. Catia do të ndikojë së tepërmi edhe në rritjen e komfortit termik të brendshëm duke përmirësuar në mënyrë të ndjeshme kushtet në të cilat do të zhvillohen orët mësimore.

Fotot e mëposhtme dokumentojnë problematikën e ngritur. Të kihet parasysh se fotot janë realizuar gjatë stinës së verës dhe në to vërejmë vetëm gjurmët e mbetura në tavane, ndërkohë që gjatë reshjeve në disa ambiente kemi edhe rrjedhje të vazhduara.









PUNIMET E PARASHIKUARA

2.1. Kerkesat e sigurimit teknik gjate zbatimit te punimeve te ndertimit

Gjate zhvillimit te punimeve ne objekt duhet te zbatohet rregullorja e sigurimit teknik ne ndertim si me poshte:

Te plotesohen kerkesat higjeno-sanitare per punetoret dhe mjetet ne objekt.

Nga kontraktori duhet te sigurohen mjetet mbrojtese sipas proceseve te punes qe kryhen ne objekt. Ne objekt duhet te mbahet rregullorja e sigurimit teknik dhe protokollet per instruksionet e dhena nga personeli inxhinjero teknik.

Te punohet sipas plan organizimit te punimeve per cdo nenobjekt sipas grafikut te percaktuar ne kontrate.

Per me hollesisht kontraktori duhet te zbatoje Rregulloren e Sigurimit Teknik per punen ne ndertim,dhene nga ISTN-ja ne Shtator 2000.

2.2 Punimet e parashikuara për ndërtimin e catisë

- 1.Prishje mur tulle rrethues përgjatë soletës (parapet)
- 2.Ndertim brez b/a 20x20 cm
- 3.Ndertim i çatise se shkolles

2.3 Afati i kryerjes se punimeve

Projekti parashikon qe per kryerjen e punimeve per objektin "Rikonstuksion i shkolles 9-vjecare, "Naun Doko" nevojitet nje afat prej 15 dite kalendarike.

2.4 Organizimi i punimeve

Theksohet se per te gjitha proceset e punes,duhet te zbatohen me rigorozitet kushtet teknike te zbatimit te punimeve gjate ndertimit dhe te perdoren material per ndertim,sipas standarteve shteterore.

2.5 Preventivi i punimeve

Preventivi i punimeve eshte hartuar ne baze te VKM 629,date 15.07.2015, me vlere te plote

= 5 103 864 lek me TVSH

Pwrgatiti : Ing. Erion Hoxha

